VENDIM
Nr. 893, datë 17.12.2014

PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË KABINETEVE NDIHMËSE, TË ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM TË INSTITUCIONEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, SI DHE PËR PROCEDURAT E HOLLËSISHME PËR PËRGATITJEN, PROPOZIMIN, KONSULTIMIN DHE MIRATIMIN E ORGANIZIMIT TË BRENDSHËM

(ndryshuar me vendimin nr. 666, datë 10.11.2021; nr. 520, datë 7.9.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 17, pika 2, 21, pika 5, 29, pika 1, dhe 30, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm.

2. Dispozitat e këtij vendimi janë të detyrueshme për zbatim për institucionet e administratës shtetërore, sipas përcaktimit të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore".

Rekomandohen drejtuesit e institucioneve qendrore të pavarura dhe të sistemit gjyqësor e të prokurorisë të zbatojnë të njëjtat standarde gjatë hartimit të strukturave organizative për administratat e institucioneve të tyre.

3. Institucionet e administratës shtetërore të organizohen mbështetur në parimin e hierarkisë, sipas të cilit vartësit, në çdo nivel, duhet të ndjekin zinxhirin vendimmarrës dhe të komunikojnë me eprorët e tyre vetëm nëpërmjet eprorit më të afërt në hierarki.

4. Marrëdhëniet mes strukturave horizontale janë marrëdhënie bashkëpunimi.

5. Strukturat organizative për kryerjen e funksioneve administrative në institucionet e administratës shtetërore veçojnë në përmbajtjen e tyre tri nivele:

- Funksionarë politikë;
- Nëpunës civilë;
- Punonjës administrativë.

6. Funksionarët politikë në ministritë e linjës organizohen brenda kabinetit të ministrit.

7. Kabineti drejtohet nga drejtori i kabinetit, i cili përgjigjet para ministrit dhe nuk është pjesë e hierarkisë administrative.

Kabineti përbëhet nga:

a) këshilltarët, që emërohen nga ministri. Numri i këshilltarëve, përfshirë drejtorin e kabinetit, nuk mund të jetë më shumë së 9 (nëntë) veta;

b) sekretaria që ka për detyrë të ndihmojë veprimtarinë e zyrës së ministrit dhe ndërveprimin ndërmjet ministrit e punonjësve të ministrisë. Numri i punonjësve të sekretarisë nuk mund të jetë më shumë së 2 (dy) veta.

8. Në shërbimin civil, nëpunësi civil përpunon dhe analizon informacionin, në bazë të të cilit formulohen projektet e politikës, duke ndjekur hierarkinë e shërbimit civil. Ky nivel bën edhe monitorimin e zbatimit të vendimeve në fushën përkatëse që mbulon ministria. Përfaqësuesi më i lartë i këtij shërbimi është sekretari i Përgjithshëm.

9. Punonjësi administrativ është punonjësi që kryen veprimtari administrative, sekretarie,

mirëmbajtjeje, shërbimi dhe ruajtjeje.

10. Funksionet, që kryhen nga institucionet e administratës shtetërore, në sistem ministror, grupohen në fushat kryesore, si më poshtë vijon:

a) Funksione politikëbërëse;

b) Funksione rregullatore;

c) Funksione të ofrimit të shërbimeve;

ç) Funksione horizontale.

11. Funksionet politikëbërëse, si rregull, kryhen nga aparatet e Kryeministrisë e të ministrive.

12. Funksionet rregullatore dhe funksionet e ofrimit të shërbimeve, si rregull, kryhen nga degët e ministrive dhe/ose institucionet në varësi të tyre ose funksioni mund të vendoset në aparatin e ministrisë.

13. Funksionet horizontale, ku përfshihen funksionet e shërbimeve mbështetëse, funksionet e financave dhe të auditimit të brendshëm, si rregull, kryhen nga vetë ministria apo institucioni i varësisë. Në rastet kur institucioni i varësisë është shumë i vogël dhe me numër personeli të kufizuar, organi qendror nga i cili varet institucioni përcakton së kush do t'i kryejë funksionet horizontale. Për degët territoriale, funksionet horizontale kryhen nga ministria apo institucioni i varësisë, pjesë e të cilit është dega.

14. Pozicionet e dedikuara për funksionet e shërbimeve mbështetëse në çdo institucion nuk duhet të kalojnë 33% të numrit të përgjithshëm të pozicioneve të institucionit.

15. Nëse aparati i ministrisë/institucionit qendror ofron shërbime mbështetëse për institucionet e varësisë, atëherë në përcaktimin e raportit të pozicioneve mbështetëse merret në konsideratë edhe numri i pozicioneve të institucionit të varësisë apo degës.

16. Institucionet e varësisë kryejnë, si rregull, funksione rregullatore dhe të ofrimit të shërbimeve, me përjashtim të rasteve kur me ligj të veçantë parashikohet ndryshe.

17. Institucionet e administratës shtetërore përbëhen nga njësi organizative të cilat krijohen në bazë të identifikimit të kompetencave kryesore. Pozicionet, që kryejnë funksione të së njëjtës fushë, grupohen në sektorë, drejtori dhe drejtori të përgjithshme, në rast së plotësohet standardi numerik për krijimin e njësisë organizative respektive, sipas përcaktimeve të këtij vendimi. Pozicionet, që kryejnë funksione të ngjashme, grupohen në të njëjtën njësi organizative.

18. Departamentet janë njësi organizative të veçanta, të cilat mbulojnë një funksion të rëndësishëm vetëm të politikëbërjes dhe krijohen vetëm në Kryeministri, ndërsa në institucionet e tjera, në rastet kur përmenden në një ligj të veçantë.

19. Degët e ministrive drejtohen nga titullari i degës. Në rastin kur dega është e organizuar në nivel drejtorie, njësia më e lartë organizative brenda saj është sektori.

20. Në degët e ministrive dhe në institucionet e varësisë, të cilat kanë një numër të reduktuar të stafit deri në 10 (dhjetë) pozicione, struktura e brendshme si rregull duhet të jetë e sheshtë, me vetëm një pozicion drejtues dhe të gjitha pozicionet e tjera që i raportojnë atij.

21. Degët e ministrive dhe institucionet e varësisë kanë një varësi funksionale edhe nga drejtoria e përgjithshme e cila mbulon fushën e veprimtarisë së tyre. Në rast së për funksionin që ato kryejnë nuk ekziston një drejtori e përgjithshme specifike, atëherë ato kanë një varësi funksionale nga drejtoria e përgjithshme e politikëbërjes në ministri. Në rast së vlerësimi i pozicionit të punës për titullarin e institucionit të varësisë është i barabartë ose më i lartë së vlerësimi i pozicionit të punës për drejtorin e përgjithshëm në ministri, atëherë institucioni e ka këtë varësi funksionale nga sekretari i përgjithshëm i ministrisë.

22. Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef/përgjegjës sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit/përgjegjësit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës.

23. Një drejtori mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy sektorë ose nëse ka të paktën

5 (pesë) punonjës.

24. Një drejtori e përgjithshme në aparatin e Kryeministrisë apo ministrive të linjës mund të krijohet nëse ka në përbërje të saj të paktën dy drejtori.

25. Funksioni i auditimit të brendshëm grupohet në një njësi organizative që, në rastin e ministrive, i raporton nga ana funksionale ministrit, ndërsa nga ana administrative varet nga sekretari i përgjithshëm dhe, në rastet e institucioneve të varësisë, i raporton titullarit të institucionit.

26. Njësitë e auditimit të brendshëm nuk krijohen në degët e ministrive. Njësitë e auditimit nuk krijohen në institucionet e varësisë, me përjashtim të rastit kur ato janë të organizuara me degë në rrethe dhe kanë numër të madh të stafit. Për institucionet që nuk kanë njësi auditimi, funksioni i auditimit kryhet nga njësia e auditimit të brendshëm të ministrisë nga e cila varen ose sipas mënyrave të parashikuara në ligjin përkatës për auditimin e brendshëm në sektorin publik.

27. Në çdo institucion, i cili ka të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, duhet të ketë të paktën një pozicion të dedikuar për funksionet e lidhura me financat e institucionit. Në rastet e institucioneve me më pak së 15 (pesëmbëdhjetë) pozicione pune, ky funksion mund të kryhet nga institucioni qendror nga i cili varet institucioni apo institucioni qendror përcakton së nga kush do të kryhet funksioni. Në institucionet e vogla, pozicionit të ngarkuar me financat mund t'i ngarkohen edhe funksione të tjera shtesë.

28. Në institucionet, që kanë të paktën 30 (tridhjetë) pozicione pune, duhet të ekzistojë një pozicion pune për menaxhimin e burimeve njerëzore. Në varësi të madhësisë së institucionit, ky pozicion mund të jetë i dedikuar ose të ketë përgjegjësinë edhe për kryerjen e funksioneve të tjera.

29. Funksioni i mbajtjes së magazinës së institucionit duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm nga ai i mbajtjes së financës së institucionit dhe në institucionet e vogla, ku nuk justifikohet ekzistenca e një pozicioni të veçantë pune, mund të vendoset në çdo pozicion tjetër pune.

29/1. Në ministritë e linjës, sipas përcaktimit të strukturës dhe organikës së tyre, krijohen "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës", të dedikuara:

a) për të identifikuar koncepte, procese novatore dhe teknika të reja, në përputhje me politikat e ministrisë, për të kryer studime dhe analiza krahasuese mbi politikat në nivel rajonal e botëror, për të analizuar të dhënat në kuadër të hartimit apo zbatimit të politikave të ndërmarra nga ministria, me qëllim zhvillimin e analizave strategjike për të zbuluar mundësi të reja inovacioni;

b) për të propozuar dhe për të menaxhuar projekte apo iniciativa zhvillimore në fushat përkatëse;

c) për të kontribuar me njohuri dhe ekspertizë të posaçme të nevojshme për një periudhë të caktuar kohore në fushën që mbulon institucioni dhe për të cilën mungojnë kapacitetet e nevojshme në institucion.

29/2. Numri i pozicioneve të punës në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës", të krijuara sipas pikës 29/1, të këtij vendimi, të jetë jo më shumë se 6 (gjashtë). Në përbërje të qendrave të ketë një drejtues të qendrës dhe ekspertët sipas fushave përkatëse.

29/3. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës" të rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.

29/4. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për punësim në "Qendrat e inovacionit dhe ekselencës" të realizohet nëpërmjet procedurave konkurruese me shpallje publike, në përputhje me kriteret e përcaktuara në përshkrimet e punës.

29/5. Shfuqizuar.

30. Struktura organizative e institucioneve të administratës shtetërore ndryshohet në rastet kur:

a) ka ndryshime të misionit të institucionit;

b) janë shtuar apo pakësuar funksionet e institucionit;

c) si rrjedhojë e analizave vjetore të kryera, rezulton së duhet të ketë një shpërndarje të ndryshme të

burimeve të shtuara për kryerjen e funksioneve.

31. Ndërtimi i strukturës dhe organikës së institucioneve të administratës shtetërore përgatitet për Kryeministrin nga Departamenti i Administratës Publike, në bazë të propozimit të marrë nga ministri propozues. Në rastet kur, mbështetur në një ligj të veçantë, struktura organizative miratohet nga një organ tjetër, merret në mënyrë të detyrueshme mendimi i Departamentit të Administratës Publike dhe i Ministrisë së Financave.

32. Departamenti i Administratës Publike, përpara dërgimit të propozimit të Kryeministri, merr mendimin e Ministrisë së Financave për kostot financiare të propozimit përkatës, në rastet kur ndryshimi i strukturës shoqërohet me efekte financiare shtesë mbi buxhetin e miratuar, kur efektet shtesë mbulohen nga fondet e lira në dispozicion të institucionit apo në rastet kur shoqërohet me reduktim të fondeve buxhetore.

33. Institucioni, i cili propozon ndryshimin e strukturës, dërgon në Departamentin e Administratës Publike të dhënat e mëposhtme:

a) Arsyet e hollësishme të nevojës për ndryshime;

b) Mendim për efektet financiare të ndryshimeve të kërkuara;

c) Përshkrimet e punës dhe kërkesat specifike për çdo pozicion pune të ri, të krijuar apo të prekur nga propozimi;

ç) Analizën sasiore për burimet e nevojshme për kryerjen e funksioneve të caktuara;

d) Një raport për pasojat që mund të ketë ristrukturimi mbi nëpunësit e institucionit dhe shpenzimet e personelit, si dhe një parashikim për sistemimin e nëpunësve, pozicionet e të cilëve preken, si pasojë e ristrukturimit.

34. Departamenti i Administratës Publike nuk shqyrton dhe nuk përgatit për Kryeministrin asnjë propozim, që nuk paraqitet në përputhje me pikën 33, të këtij vendimi, dhe që nuk shoqërohet me mendimin e Ministrisë së Financave për efektet financiare.

35. Departamenti i Administratës Publike mund të kërkojë sqarime shtesë nga institucioni propozues për ndryshimin e strukturës ose mund të bëjë komente për propozimin përpara së ta dërgojë për miratim të Kryeministri.

36. Në rast së ka qëndrime të kundërta ndërmjet Departamentit të Administratës Publike dhe institucionit propozues, institucioni është i detyruar të shqyrtojë komentet dhe sugjerimet e Departamentit të Administratës Publike dhe, sipas rastit, t'i reflektojë ose të argumentojë mosreflektimin e tyre. Në rast së vazhdon të ketë qëndrime të kundërta ndërmjet dy institucioneve, Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave organizon një takim të përbashkët për bashkërendimin e punës ndërmjet të dyja institucioneve.

37. Departamenti i Administratës Publike i paraqet Kryeministrit projekturdhrin për miratimin e strukturës dhe të organikës së institucionit, të shoqëruar me relacionin përkatës, ku përcaktohen shkaqet dhe arsyet që kanë çuar në ndryshim dhe objektivat që parashikohen të arrihen.

38. Urdhri për miratimin e strukturës hyn në fuqi menjëherë, por fillon të prodhojë efektet financiare jo më vonë së 30 (tridhjetë) ditë nga data e hyrjes në fuqi, periudhë në të cilën duhet të përfundojnë të gjitha veprimet për sistemimin e punonjësve ekzistues në strukturën e re.

39. Menjëherë pas miratimit të urdhrit të Kryeministrit për miratimin apo ndryshimin e strukturës dhe organikës, institucioni, për të cilin është miratuar urdhri, dërgon një kopje të tij në Ministrinë e Financave.

40. Fillimi i prodhimit të efekteve financiare të strukturës së re fillon, sipas rastit, në momentin e:

a) konfirmimit nga Departamenti i Administratës Publike të propozimit për ripozicionimin e të gjithë punonjësve në strukturën e re, por jo më vonë së afati i përcaktuar në pikën 38, të këtij vendimi;

b) lëshimit të urdhrit nga titullari i institucionit për njësinë e financës, për rastet e punonjësve që nuk janë subjekt i legjislacionit për shërbimin civil, por jo më vonë së afati i përcaktuar në pikën 38, të këtij

vendimi.

41. Vendimi nr. 474, datë 16.6.2011, i Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike", shfuqizohet.

42. Ngarkohet Departamenti i Administratës Publike për hartimin e udhëzimit shpjegues për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama